



PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2023

SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT

Gjuhë shqipe dhe letërsi - Arsimi i orientuar (artistik dhe sportiv) dhe arsimi profesional Varianti B

Shënim: Vlerësuesit e testeve janë trajnuar, që të vlerësojnë çdo përpjekje të nxënësit dhe të jenë të kujdesshëm, sidomos në pyetjet e hapura, që kanë më shumë se një mundësi përgjigjeje dhe ku nxënësit shprehen shpesh, edhe me përgjigje të përafërta.

PJESA I

Romancieri, dëshmitar i epokës së tij

Përgjigjet e sakta për çdo pyetje të testit

Pyetja 1	A	1 pikë
Pyetja 2	D	1 pikë
Pyetja 3	B	1 pikë
Pyetja 4	A	1 pikë
Pyetja 5	A	1 pikë
Pyetja 6	B	1 pikë
Pyetja 7	B	1 pikë
Pyetja 8	D	1 pikë
Pyetja 9	A	1 pikë
Pyetja 10	A	1 pikë

Pyetja 11 **1 pikë**
Përgjigje:

Lidhëza bashkërenditëse: **dhe**

- 1 pikë** Nëse nxënësi gjen lidhëzën bashkërenditëse.
0 pikë Nëse përgjigjja është gabim, ose nuk ka përgjigje fare.
-

Pyetja 12 **1 pikë**

Përgjigje:

Autorja ditarin e saj e quante ndryshe edhe **fletore**.

- 1 pikë** Nëse nxënësi gjen si e quan ndryshe autorja ditarin.
0 pikë Nëse përgjigjja është gabim, ose nuk ka përgjigje fare.
-

Pyetja 13 **2 pikë**
Model përgjigjeje:

Karakteristikat gjuhësore:

- Përdorimi i vetës së parë. (Tashmë unë e di mirë se të shkruash shërben gjithsesi për t'i dhënë botës informacion.)
- Përdorimi i foljeve në kohën e tashme dhe në kohën e shkuar (trajton, shihja etj.)
- Gjuha e përdorur është e ngjashme me ligjërimin bisedor, e thjeshtë, e qartë dhe e prekshme. (Rreth meje shihja njëriqë që nuk ndiheshin mirë.)
- Përdorimi i dendur i foljeve që tregojnë veprime, ndjenja, ngjarje etj. (shkruaja, shihja, pyesja, lindi, jep etj.)
- Etj.

- 2 pikë** Nëse nxënësi gjen një karakteristikë gjuhësore dhe jep një shembull ilustrues.
1 pikë Nëse nxënësi gjen vetëm një karakteristikë gjuhësore.
0 pikë Nëse nxënësi nuk gjen asgjë, ose jep përgjigje të gabuar.
-

Pyetja 14 **2 pikë**
Përgjigje:

Gjymtyrët homogjene: Cehovin, Tolstoin, Dostojevskin apo Turgenievin.
Ato janë shprehur me emra.

- 2 pikë** Nëse nxënësi gjen të gjitha gjymtyrët homogjene dhe tregon se janë shprehur me emra.
1 pikë Nëse nxënësi gjen vetëm gjymtyrët homogjene.
0 pikë Nëse përgjigjja është gabim, ose nuk ka përgjigje fare.
-

Pyetja 15**2 pikë****Përgjigje:**

Arsyeja: Autorja përmend disa shkrimtarë në shkrimin e saj për të konkretizuar idenë me shembuj, mbi të gjitha për ta bërë të besueshme, për ta bindur lexuesin.

Përse i shërben tekstit: Shembujt janë burime të gjalla për idenë apo fakte për idenë e shprehur.

2 pikë Nëse nxënësi jep arsyen e listimit të autorëve të njohur dhe tregon funksionin e kësaj në shërbim të kuptimit të tekstit.

1 pikë Nëse nxënësi jep vetëm arsyen e listimit të autorëve të njohur.

0 pikë Nëse përgjigjja është gabim, **OSE** nuk ka përgjigje fare.

Shënim: Vlerësuesi do të vlerësojë me pikë çdo përgjigje të përafërt të nxënësit që të çon në modelet e përgjigjeve më lart.

Pyetja 16**3 pikë****Përgjigje:**

- Romancierët e konceptojnë botën në mënyra të ndryshme. Në përgjithësi ata e ndajnë atë në kuti-kuti duke krijuar kështu një bazë informacioni. Ata japin informacion portretizues të plotë ose të pjesshëm për kohën.
- Informacionet që merren nga romancierët portretizojnë kohën, janë një panoramë e përgjithshme dhe ndonjëherë e detajuar e kohës. Romancierët përmes veprave të tyre, na japin një sërë mësimesh për jetën, kohën, dukuri, vende, ngjarje, njerëz etj.
- Shembull: Psh Proust jep një portret të plotë të shoqërisë së kohës së tij. **OSE** Për Rusinë nuk do dinim asgjë pa shkrimtarë si Çehovin, Turgenievin, Dostojevskin, Tolstoin. **OSE** unë lexoj romane me qëllim informimi.

3 pikë Nëse nxënësi identifikon se si e konceptojnë botën romancierët, sqarojnë pse informacionet që merren nga romanet janë të rëndësishme dhe e ilustrojnë me një shembull.

2 pikë Nëse nxënësi identifikon se si e konceptojnë botën romancierët dhe sqarojnë pse informacionet që merren nga romanet janë të rëndësishme **OSE** identifikon se si e konceptojnë botën romancierët dhe e ilustrojnë me një shembull **OSE** sqarojnë pse informacionet që merren nga romanet janë të rëndësishme dhe e ilustrojnë me një shembull.

1 pikë Nëse nxënësi identifikon se si e konceptojnë botën romancierët **OSE** sqarojnë pse informacionet që merren nga romanet janë të rëndësishme.

0 pikë Nëse përgjigjja është gabim, **OSE** nuk ka përgjigje fare.

Shënim: Vlerësuesi do të vlerësojë me pikë çdo përgjigje të përafërt të nxënësit që të çon në modelet e përgjigjeve më lart.

Pyetja 17**2 pikë****Përgjigje:**

Rrethanori është: rreth meje

Lloji: vendi

2 pikë Nëse nxënësi gjen rrethanorin dhe llojin e tij.

1 pikë Nëse nxënësi gjen vetëm rrethanorin.

0 pikë Nëse përgjigjja është gabim **OSE** nuk ka përgjigje fare.

Pyetja 18 **3 pikë****Përgjigje:**

Ernest Heminguej jetoi nga 1899-1961. Ai njihet si autori i veprave të famshme si: "Plaku dhe deti", " Dhe dielli lind", "Lamtumirë Armë".

- 3 pikë** Nëse nxënësi vendos pikën, dy pikat dhe thonjëzat.
2 pikë Nëse nxënësi vendos vetëm dy nga shenjat e pikësimit.
1 pikë Nëse nxënësi vendos vetëm një nga shenjat e pikësimit.
0 pikë Nëse përgjigjja është gabim, **OSE** nuk ka përgjigje fare.

PJESA II **Homeri "Iliada"**

- Pyetja 19** **A** **1 pikë**
Pyetja 20 **C** **1 pikë**
Pyetja 21 **D** **1 pikë**
Pyetja 22 **D** **1 pikë**
Pyetja 23 **D** **1 pikë**
Pyetja 24 **A** **1 pikë**
Pyetja 25 **A** **1 pikë**
Pyetja 26 **B** **1 pikë**
Pyetja 27 **A** **1 pikë**
Pyetja 28 **C** **1 pikë**

Pyetja 29 **2 pikë****Model përgjigjeje:***Similituda:*

Si spata që dora e burrit mjeshtrisht i mëshon, sa çan pajorin vetëm me një t'rame, dhe krahut tij ma tepër ia shton hovin.

Qëllimi:

Të përforcojë tiparet karakteristike të Hektorit si: i ashpër, i fortë, i beftë, i padiskutueshëm, i pamëshirshëm për armikun.

- 2 pikë** Nëse nxënësi gjen similitudën dhe shpjegon funksionin.
1 pikë Nëse nxënësi gjen vetëm similitudën.
0 pikë Nëse nxënësi përgjigjet gabim, ose nuk ka përgjigje fare.

Shënim: Vlerësuesi do të vlerësojë me pikë çdo përgjigje të përafërt të nxënësit që të çon në modelet e përgjigjeve më lart.

Pyetja 30

2 pikë

Model përgjigjeje:

Agamemnoni është **mbreti**, komandanti i fuqishëm në luftë e në fjalë, autoritar i prerë dhe i padiskutueshëm, bën ushtrinë të mbaj vesh, të pushojë të shtënat.

Shembull:

Gjer sa me za ushtues rrebt u vikati, mbreti i fatosave Agamemnoni.

OSE

të gjithë me'i herë pa zhurmë pushuen bataren.

2 pikë

Nëse nxënësi përshkruan portretin e Agamemnonit dhe jep një shembull ilustrues.

1 pikë

Nëse nxënësi përshkruan portretin e Agamemnonit.

0 pikë

Nëse nxënësi përgjigjet gabim, ose nuk ka përgjigje fare.

Pyetja 31

3 pikë

Model përgjigjeje:

Tiparet: Zemërgur, Zemër trime.

Mjeti stilistik: Epiteti metaforik.

3 pikë

Nëse nxënësi gjen dy nga tiparet e Hektorit dhe përcakton mjetin stilistik

2 pikë

Nëse nxënësi gjen vetëm dy tiparet **OSE** vetëm një tipar dhe përcakton mjetin stilistik.

1 pikë

Nëse nxënësi shkruan vetëm një nga tiparet.

0 pikë

Nëse nxënësi përgjigjet gabim, ose nuk ka përgjigje fare.

Shënim: Vlerësuesi do të vlerësojë me pikë çdo përgjigje të përafërt të nxënësit që të çon në modelet e përgjigjeve më lart.

Pyetja 32

3 pikë

Model përgjigjeje:

- Cilësi e Paridit: i bukur (**I pramshmi lekë**)
- Cilësi e Menelaut: Trimëria (**Trim Menelau**)
- Duket se autori parapëlqen më shumë Meneaun, duke i veshur kështu atij tipare trimërie. Paridit i theksohet pamja, trimëria nuk është pika e tij e fortë. Iliada është një poemë epike dhe si e tillë në të mbizotërojnë notat heroike.

3 pikë

Nëse nxënësi gjen një cilësi të Paridit dhe Menelaut dhe analizon zgjedhjen e autorit.

2 pikë

Nëse nxënësi gjen një cilësi të Paridit **OSE** Menelaut dhe analizon zgjedhjen e autorit.

1 pikë

Nëse nxënësi gjen një cilësi të Paridit **OSE** Menelaut.

0 pikë

Nëse nxënësi përgjigjet gabim, ose nuk ka përgjigje fare.

Pyetja 33 **2 pikë****Model përgjigjeje:***Detaje të të folurit të Hektorit:*

Hektori dallohet për forcën e tij bindëse. Ai u drejtohet të dy palëve duke shprehur respekt dhe i gjithë kampi hesht. Këtu del në pah aftësia drejtuese, lider, komandant por edhe si njeri i fjalës së mençur.

Detaje të nxjerra nga ndërhyrjet e narratorit:

Narratori ndërhyr në fjalinë e fundit kur pas fjalës së tij bie një heshtje varri sepse në këto fjalë kishte barazi, respekt, mençuri dhe objektivitet.

Kështu Hektori edhe sipas narratorit del si një lider i mençur, i respektuar, i drejtë etj. Pra narratori e i prezanton lexuesit në mënyrë të përmbledhur karakterin e Hektorit.

- 2 pikë** Nëse nxënësi portretizon Hektorin sipas dy varianteve.
1 pikë Nëse nxënësi portretizon Hektorin sipas njërit variant.
0 pikë Nëse nxënësi përgjigjet gabim, ose nuk ka përgjigje fare.

Shënim: Vlerësuesi do të vlerësojë me pikë çdo përgjigje të përafërt të nxënësit që të çon në modelet e përgjigjeve më lart.

Pyetja 34 **2 pikë****Model përgjigjeje:****Armët e hijshme.**

Lufta në antikitet konsiderohej vlerë. Po kështu trimat dhe armët e tyre. Meqenëse trimëria dhe lufta e lartësonte njeriun, armët pranë tij i jepnin hije. Mesazhi që përcillet ka lidhje me mentalitetin e kohës që arma e zbukuron luftëtarin. Në fragmentin tonë përdorimi i kësaj shprehje nga Hektori tregon vlerësimin që ai kishte për ushtarët e dy kampeve.

Dhantitë e ambla

Këto janë të ambla, fisnike, të kandshme. Në këtë këndvështrim ai ia njeh vetes këto attribute. Është një shprehje që përcjell emocion tek lexuesi. Del jashtë kontekstit të luftës dhe trimërisë dhe na çon tek një linjë e dytë: marrëdhënien hyjni-njerëz në vepër.

- 2 pikë** Nëse nxënësi i shpjegon përafërsisht si modelet më lart të dyja shprehjet.
1 pikë Nëse nxënësi shpjegon përafërsisht si modelet më lart vetëm njëren nga shprehjet
0 pikë Nëse nxënësi përgjigjet gabim, ose nuk ka përgjigje fare.

Pyetja 35 **2 pikë**

- Ta marrë Helenën me gjithë pasuritë e saj, ta çojë në shtëpinë e vet. (Ai që prej dyve del fitues mbi shoqin, ta marrë gruen me pasuritë e saja ta çojë n'shpi t' vet.)
- Të bëjë armëpushim (Dhe këtu benë tue rrahë t'bjamë armpushim me besë e lidhje t'forta".)

- 2 pikë** Nëse nxënësi identifikon dy kushte që duhet të zbatohen nga të dy kampet.
1 pikë Nëse nxënësi identifikon një nga kushtet që duhet të zbatohen nga të dy kampet..
0 pikë Nëse nxënësi përgjigjet gabim, ose nuk ka përgjigje fare.

Shënim: Vlerësuesi do të vlerësojë me pikë çdo përgjigje të përafërt të nxënësit që të çon në modelet e përgjigjeve më lart.

Pyetja 36

Për pjesën **ese** do të ndiqen në vlerësim kriteret e mëposhtme:

Shtjellimi i idesë 2 pikë

- shkruan një ese, ku argumenton pse është më mirë ose jo të kesh shumë burime para se të shkosh për të vizituar një vend. Të argumentojë që kënaqësia që merr nga vizita e një vendi është impresionuese në çdo rast të zgjedhur nga ai.
- zbërthen argumentet e dhëna përmes detajesh të shumëllojshme shpjeguese dhe përshkrimi mbështet shpjegimin përgjatë gjithë shtjellimit;
- sjell përvoja të ndryshme personale, të cilat mbështetin bindshëm argumentin.

Organizimi dhe struktura 2 pikë

- përdor strukturë të qartë eseje: hyrje-zhvillim-mbyllje.
- siguron kalimin rrjedhshëm në paragrafët zhvillues;
- grupon çështjet në paragrafë të organizuar drejt, qartë, saktë dhe në mënyrë të plotë e të logjikshme;
- zgjedh dhe përdor konektorët e duhur për të siguruar koherencën dhe kohezionin e tekstit. Këta janë të shumëllojshëm dhe i shmangen fjalorit të gjuhës së përditshme;
- përcjell konkluzionin personal në raport me temën (paragrafi përmbyllës).

Stili dhe origjinaliteti 2 pikë

- përdor një gjuhë të qartë dhe origjinale, për krijimin e një pershtypjeje të plotë për atë që shprehet në raport me temën;
- përdor një gjuhë të pasur me detaje të shumta që mbështetin idenë dhe që ndikojnë dhe vënë në lëvizje imagjinatën e lexuesit;
- përdor gjuhë subjektive dhe shpesh format shpjeguese gërshetohen me detaje përshkruese;
- përdor fjalor të pasur dhe të shumëllojshëm, me shprehje të zgjedhura që sigurojnë origjinalitet në shkrim dhe dëshmojnë për një formim të mirë jo vetëm letrar, por edhe gjuhësor.

Saktësia gjuhësore 2 pikë

- përdor drejt struktura të fjalive, të cilat mbështetin nga pikëpamja gjuhësore përmbajtjen e esesë;
- shkruan pa gabime fjalë të përdorimeve të shpeshta (ose jo), si dhe ndërton drejt, sipas kuptimit apo kumtimit, të gjitha llojet e fjalive;
- përdor saktë shenjat e pikësimit, të të gjitha llojeve: pikë, presje, dy pika, pikëçuditëse, pikëpyetje, vizë ndarëse etj., gjë që dëshmon për njohje shumë të mirë të rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe.
- shkruan saktë nga pikëpamja e drejtshkrimit, sintaksës e pikësimit, gjë që mbështet në mënyrë të plotë strukturën e fjalive.

Shënim: Në vlerësimin e esesë, rubrikat që do të vlerësohen nuk mund të shihen të palidhura me njëra-tjetrën, pasi ato nuk mund të kenë një mëvetësi të plotë, ato shihen në harmoni. Nga ana tjetër, ky komision do të ketë parasysh, që për rubrikën stili (ku deri më sot janë treguar më të rezervuar) të mbahet në konsideratë që shkruesi i esesë është një nxënës dhe jo një shkrimtar. Komisioni i vlerësimit do të vlerësojë çdo përpjekje të nxënësit.

